



VENDIMI MBI PRANUESHMËRINË DHE MERITAT

Data e miratimit: 26 mars 2021

Nr. i lëndës: 2016-20

Dragica Ćerimi

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 26 mars 2021, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaél METTRAUX, kryesues
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga:

Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019,

Pas shqyrtimit përmes mjeteve elektronike në pajtim me Rregullën 13(3) të Rregullores së punës së Panelit, vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesa në këtë lëndë është regjistruar në Panel më 30 qershor 2016.
2. Me një letër të datës 1 korrik 2016, Paneli informoi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i Kosovë ("Misioni") se kjo lëndë ishte regjistruar.
3. Më 28 qershor 2017, Paneli dërgoi një kërkesë për informacion shtesë përmes përfaqësuesit për familjet serbe të Qendrës Burimore të Personave të Zhdukur (MPRC), një organizatë joqeveritare me seli në Prishtinë, që nuk ishte asnjë informacion të mëtejshëm në lidhje me këtë rast.

4. Më 20 shtator dhe 17 tetor 2017, Paneli dërgoi dy kërkesa të tjera për informacion shtesë përmes MPRC.
5. Më 20 tetor 2017, u mor një dokument shtesë.
6. Më 8 dhjetor 2017, Paneli i transmetoi një Deklaratë të Fakteve dhe Pyetjeve shefit të Misionit ("ShM"), EULEX-i Kosovë, duke e ftuar Misionin të paraqesë përgjigje dhe vërejtje me shkrim mbi ankesat jo më vonë se 26 janari 2018.
7. Me anë të një letre të 19 janarit 2019, Misionit iu kërkuar të jepte përgjigje për pyetjet deri më 16 shkurt 2019.
8. Me një letër të 8 prillit 2019, Misionit iu kërkuar përsëri të jepte përgjigje për pyetjet sa më shpejt të ishte e mundur.
9. Me anë të një letre të 31 janarit 2019, ankuesit iu kërkuar të paraqesë një kopje të nënshkruar të formularit të aplikimit. Është dorëzuar më 2 shkurt 2019.
10. Më 18 dhjetor 2019, ushtruesi i detyrës së ShM-së paraqiti vërejtjet e tij mbi lëndën.
11. Më 30 dhjetor 2019, letra e ushtruesit të detyrës së ShM-së u paraqit për informacion ankueses, të cilit iu dha kohë deri më 30 janar 2020 për të bërë ndonjë parashtresë të mëtejshme në përgjigje të asaj letre. Ankuesi nuk dha ndonjë përgjigje.
12. Me një letër të 18 shtatorit 2020, Paneli informoi Misionin se, për të shpejtuar procedurat, Paneli kishte për qëllim të merrej me çështjet e pranueshmërisë dhe meritës në të njëjtën kohë në një vendim të vetëm. Për këtë qëllim, Paneli ftoi Misionin të paraqesë parashtresat e tij për meritë në ato raste kur ai kishte dhënë tashmë komentet e tij mbi pranueshmërinë.
13. Më 11 dhjetor 2020, Misioni paraqiti komente shtesë në lidhje me meritën e ankesës.
14. Më 17 dhjetor 2020, komentet e Misionit për meritat iu përcollën ankueses, e cila u ftua të paraqesë komentet e saj mbi meritat e lëndës, nëse ka pasur, para 31 janarit 2021.
15. Për shkak të një ndërlikimi të paparashikuar me dërgimin e komunikimeve postare, Paneli vendosi të zgjasë afatin që ankuesi të paraqesë komente mbi meritat e lëndës. Me anë të një letre të datës 11 shkurt 2021, ankuesi u informua se afati ishte zgjatuar deri më 19 mars 2021.
16. Asnjë parashtresë tjetër nuk u pranua në këtë rast.

II. FAKTET

17. Faktet e lëndës, siç duket nga ankesa, mund të përmbliidhen si më poshtë. Më 10 gusht 1999, djali i ankuesit, Samet Ćerimi, u zhduk në komunën e Zubin Potokut, rajoni i Mitrovicës.
18. Më 17 gusht 1999, ankuesja raportoi zhdukjen e djalit të saj në Policinë Ushtarake të KFOR-it.

19. Më 17 Mars 2000, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq ("KNKK") hapi një kërkesë gjurmimi për Samet Çerimin.
20. Më 19 maj 2000, ankuesja raportoi zhdukjen e djalit të saj në Policinë e UNMIK-ut.
21. Më 26 mars 2001, Njësia për Hetimin e Policisë së UNMIK-ut në Mitrovicë lëshoi një raport hetimor ku thuhet se kufoma e Samet Çerimit të zhdukur ishte gjetur në lumin Ibër dhe për këtë arsye hetimi u ndal. Sidoqoftë, çështja në lidhje me një "vrasje të dyshuar" ishte ende nën hetim.
22. Më 30 mars 2001, prindërit e Çerimit nuk e njohën djalin e tyre në fotografitë që u treguan atyre të trupit që ishte gjetur. Si rezultat, rasti u mbajt "i hapur".
23. Dokumentet e dorëzuara nga UNMIK-u nuk përmbajnë informacione rreth asaj se çfarë hapash hetimor janë kryer nga UNMIK-u. Baza e të dhënave të lëndëve të UNMIK-ut që më vonë do t'i transmetohen EULEX-it nuk tregoj statusin e lëndës.
24. Më 11 prill 2013, një kufomë tjetër u gjet në komunën e Vushtrrisë.
25. Më 19 shtator 2013, kufoma u identifikua nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore të EULEX-it Kosovë, si i Samet Çerimit.
26. Më 19 shtator 2013, Zyra e Ekzaminuesit Mjekësor të Departamentit të Mjekësisë Ligjore të EULEX-it Kosovë, lëshoi një certifikatë vdekjeje për Samet Çerimin. Shkaku i vdekjes u verifikua nga një autopsi dhe u regjistrua si një *'e shtënë me armë në kokë'*.
27. Më 20 shtator 2013, mbetjet mortore të Samet Çerimit iu dorëzuan ankuesit nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore të EULEX-it Kosovë.

III. ANKESA DHE QËNDRIMI

28. Ankuesja pretendoi se kurrë nuk ka pasur ndonjë hetim rreth vrasjes së djalit të saj, i cili u zhduk në gusht 1999 dhe i cili u gjet se ishte vrasë.
29. Paneli konsideron që ankesa ka të bëjë me të paktën dy të drejta themelore të veçanta të pasqyruara në dispozitat e mëposhtme: Neni 2 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"), e cila garanton të drejtën themelore të një personi për jetë dhe, nën drejtimin e saj procedural, parashikon një detyrim për të hetuar raste të vdekjeve të dyshimta; dhe, neni 3 i Konventës që garanton të drejtën e një personi për të mos iu nënshtruar torturave, ndëshkimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.
30. Për më tepër, ankesa mund të jetë e rëndësishme për të drejtat e parashikuara në nenet 8 dhe 13 të së njëjtës Konventë, të cilat garantojnë, përkatësisht, të drejtën për jetë familjare dhe të drejtën për zgjidhje efektive për cilindo, të drejtat dhe liritë e të cilit në Konventë janë shkelur. Të njëjtat të drejta mbrohen nga një numër traktatesh të tjera ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Këto të drejta janë pjesë e një grupi thelbësor të të drejtave themelore të njeriut që u garantohen të gjithëve si çështje e së drejtës zakonore ndërkombëtare.
31. Duke marrë parasysh marrëdhëniet e ngushta familjare midis viktimës kryesore - të Samet Çerimit - dhe ankueses - Dragisa Çerimi (nëna e Samet Çerimit) - Paneli është i bindur që ankuesi mund të konsiderohet si viktimë dytësore e shkeljeve të pretenduara dhe që, si e

tillë, një viktimë e mundshme në përputhje me rregullën 25(1) të rregullores së punës së Panelit.

IV. PARASHTRESAT E PALËVE NË LIDHJE ME PRANUESHMËRINË

Ankuesi

32. Siç u përmblohd më lart, ankuesja pretendon se, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, EULEX-i Kosovë do të duhej të kishte hetuar zhdukjen dhe vrasjen e djalit të saj dhe për fat të keq nuk kishte arritur ta bënte këtë në shkellje të të drejtave themelore të saj dhe të djalit të saj.

Shefi i Misionit ("ShM")

33. Në parashtrimet e tij, ShM-ja tregon se, në kuadër të dorëzimit të lëndëve dhe dosjeve të lëndëve nga UNMIK-u tek EULEX-i në periudhën dhjetor 2008 deri në mars 2009, Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës - NJHKL e EULEX-it ka marrë disa dokumente që ka të bëjë me zhdukjen e Samet Çerimit. Në momentin e dorëzimit nga UNMIK-u tek EULEX-i, çështja e Samet Çerimi u përfshi në Njësinë e Personave të Zhdukur të UNMIK-ut - bazën e të dhënave të NJPZH për personat e zhdukur.

34. Në veçanti, EULEX-i pranoi dokumente që tregojnë se ankuesja kishte raportuar zhdukjen e djalit të saj në KFOR-in francez dhe në Policinë e UNMIK-ut. Misioni deklaroi se,

"Në një raport hetimor të datës 26 mars 2001 të lëshuar nga Njësia për Hetimin e Policisë së UNMIK-ut në Mitrovicë thuhet se hetimi për zhdukjen e Samet Çerimit po "ndalej", sepse kufoma e tij ishte gjetur në lumin Ibër, ndërsa rasti që kishte të bënte me një 'vrasje të dyshuar' ishte ende nën hetim. Një raport i Njesisë për Hetimin e Policisë së UNMIK-ut në Mitrovicë i datës 30 mars 2001 tregon se në ditën e përmendur, policia e UNMIK-ut u takua me familjen e Samet Çerimi (babai i tij dhe ankuesi) për të krahasuar fotografitë e tij me ato të trupit të gjetura në lumin Ibër. Raporti thekson se prindërit e Samet Çerimit nuk e njohën djalin e tyre në fotografitë e treguara atyre nga policia e UNMIK-ut, dhe se për këtë arsye rasti i personit të zhdukur do të mbahej 'i hapur'. Asnjë hap tjetër hetimor duket se nuk është kryer nga UNMIK-u pas asaj date. Baza e të dhënave e MPU Microsoft Access e dorëzuar tek EULEX-i nuk tregon statusin e lëndës në momentin e dorëzimit'.

35. ShM-ja vëren se, sipas të dhënave në dispozicion të Misionit, as ankuesi dhe as ndonjë anëtar tjetër i familjes nuk sollën kurrë zhdukjen dhe vrasjen e djalit të ankuesit në vëmendjen e Misionit.
36. Lidhur me regjistrimin dhe kategorizimin e rasteve të dorëzuara nga UNMIK-u tek EULEX-i, Misioni tregon se përveç dosjeve të lëndëve që EULEX-i i mori nga UNMIK-u në 2008-2009, kishte edhe disa baza të dhënash në Microsoft Access që u dorëzuan. Këto përfshinin një për dosjet e policisë "për krime lufte" dhe një tjetër për rastet e "personave të zhdukur". Rasti i Samet Çerimit u përmend në këtë bazë të dhënash, por jo në bazën e parë të të dhënave. Nuk kishte asnjë vërejtje specifike që tregon statusin e këtij rasti si "të hapur", "aktiv" ose "joaktiv".
37. Lidhur me masën në të cilën Misioni ndërmoi hapa për të identifikuar dhe hetuar rastet e zhdukjeve me forcë dhe/ose vrasjeve, Misioni thekson, ndër të tjera, se:

“Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, në fuqi në kohën e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në sistemin e drejtësisë penale, nuk përmbante ndonjë referencë të qartë për zhdukjet me forcë’. Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (REG. UNMIK. 2003/25) dhe Kodi Penal i Kosovës (Nr. 04/L-082) që e zëvendësuan atë, si dhe Kodi aktual Penal i Kosovës (Nr. 06/L-074), i referohen zhdukjeve me forcë si një nga veprat penale, të cilat, në rrethana të caktuara, mund të përbëjnë krime kundër njerëzimit, jo krime lufte. Zhdukjet me forcë gjithashtu nuk ishin parashikuar në bazë të ligjit penal të zbatueshëm në Kosovë gjatë dhe menjëherë pas konfliktit, duke përfshirë Kodin Penal të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë të vitit 1976. EULEX-i, megjithëse jo drejtpërdrejtë, hetoi dhe ndoqi penalisht raste të zhdukjeve me forcë në kornizën e rasteve të krimeve të luftës”.

38. Lidhur me përfshirjen e organeve të EULEX-it në rastin aktual, Misioni thekson se:

“Më 20 prill 2013, NJHKL e EULEX-it mori informacion se kocka njeriu ishin zbuluar në komunën e Vushtrrisë. Një autopsy u krye nga stafi i EULEX-it i Departamentit të Mjekësisë Ligjore - DFM (tani Instituti i Mjekësisë Ligjore - IFM) më 22 prill 2013. Më 19 shtator 2013, personeli i EULEX-it në DFM lëshoi një certifikatë vdekjeje dhe një certifikatë identifikimi për Samet Çerimi; eshtrat e tij iu dorëzuan ankuesit në 20 shtator 2013. Sipas të dhënave të EULEX-it, nuk kishte asnjë përfshirje të Misionit në hetimin e vrasjes së Samet Çerimit”.

39. Lidhur me ankesat specifike kundër EULEX-it, ShM-ja thekson se ai merr parasysh faktin se Paneli e ftoi EULEX-in të paraqesë vërejtje mbi pranueshmërinë dhe meritat e ankesës vetëm në lidhje me nenet 2 dhe 3 të Konventës, dhe për këtë arsye kontributi i Misionit do të jetë i kufizuar vetëm në këto dy nene.

40. Në parashtrimet e tij në lidhje me këto dispozita, Misioni vë në pah praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut në raste të ngjashme dhe nuk e konteston pranueshmërinë e kësaj ankese sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

41. Misioni më tej vëren se ankuesi nuk i referohet ndonjë shkeljeje të veçantë ose shkeljes së të drejtave themelore nga EULEX-i Kosovë. Misioni thekson se është Paneli ai që vlerëson se ankesa ngre çështje sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës, jo ankuesi. Misioni vëren se ankuesi nuk paraqet ndonjë argument për shqyrtim nga Paneli.

V. VLERSIMI I PANELIT LIDHUR ME PRANUESHMËRINË E LËNDËS

Mandati i Panelit (Rregulli 25, paragrafi 1, i Rregullores së Procedurës) dhe kufizimet e qenësishme të vendosura për Misionin në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

42. Siç u përmend më lart, ShM-ja nuk e konteston pranueshmërinë e kësaj lënde.

43. Pasi të ketë shqyrtuar kërkesat përkatëse të pranueshmërisë, Paneli është i bindur që lënda është vërtet e pranueshme.

VI. VLERSIMI I PALËVE LIDHUR ME MERITAT E LËNDËS

Ankuesi

44. Siç u përmend më lart, ankuesja pretendon që, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, EULEX-i Kosovë do të duhej të kishte hetuar zhdukjen dhe vrasjen e djalit të saj dhe me faj nuk kishte arritur ta bënte këtë në shkelle të të drejtave themelore të saj dhe të djalit të saj. Paneli ka vendosur më lart që ankuesi aktual duhet të merret në konsideratë në bazë të neneve 2 (pjesa procedurale), 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Shefi i Misionit

45. Me një letër të 11 dhjetorit 2020, shefi i Misionit iu përgjigj ftesës për të dhënë vërejtje shtesë mbi meritat e lëndës, përtej asaj që u tha në vërejtjet e tij mbi pranueshmërinë.
46. Misioni bën një numër parashtrimesh të përgjithshme në lidhje me disa nga sfidat praktike që lidhen me hetimin e këtij lloji të lëndëve dhe pranon se menaxhimi i dosjeve që mori nga UNMIK-u ka qenë veçanërisht sfidues.
47. Misioni sqaron se nën mandatin e tij aktual, EULEX-i nuk është i autorizuar të zbulojë informacione mbi hetimet e vazhdueshme që ka marrë gjatë aktiviteteve të tij të monitorimit. Misioni parashtron se:

“Prandaj, kur fton ankuesit të kontaktojnë institucionet kompetente, Misioni thjesht po i referon ata tek autoritetet që sipas ligjit janë kompetent dhe të autorizuar për t’ju lëshuar atyre informacion në lidhje me ndonjë hap hetimor që ata mund të kenë ndërmarrë që nga fundi i mandatit ekzekutiv të EULEX-it në sistemin e drejtësisë penale në qershor 2018”.

48. Në lidhje me detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut, Misioni rikujton se:

"Detyrimi procedural sipas nenit 2 të [Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut], është një prej *“mjeteve”* e *“jo rezultati”*. Thelbësore në vlerësimin e zbatimit të tij është se *“autoritetet kanë bërë gjithçka që në mënyrë të arsyeshme mund të pritej prej tyre në rrethanat e rastit”*. (Shih, për shembull, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNj-ja) *Trivkanović kundër Kroacisë*, nr. 12986/13, Aktgjykimi i 6 korrikut 2017, par. 78; *Borojević dhe të tjerët k. Kroacisë*, nr. 70273/11, Aktgjykimi i 4 prillit 2017, par. 57; *Nježić dhe Štimac k. Kroacisë*, nr. 29823/13, Aktgjykimi i 9 prillit 2015, par. 69).

49. Për më tepër, Misioni ka përmendur se:

“Natyra dhe shkalla e shqyrtimit duhet të vlerësohet në bazë të të gjitha fakteve përkatëse dhe në lidhje me realitetet praktike të punës hetimore.” (Shih, për shembull, GJEDNj *Cindrić dhe Bešlić kundër Kroacisë*, nr. 72152/13, Gjykimi i 6 shtatorit 2016, par.69; *Zdjelar dhe të tjerët k. Kroacisë*, nr. 80960/12, Aktgjykimi i 6 korrikut 2017, par. 83; *Velcea dhe Mazare kundër Rumanisë*, nr. 64301/01, Aktgjykimi i 1 dhjetorit 2009, para. 105; dhe *Armani da Silva kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 5878/08 5878/08, Aktgjykimi i datës 30 mars 2016, par. 234). ”

50. Misioni gjithashtu parashtron se:

“Siç pranohet në praktikën gjyqësore të konsoliduar të Panelit, si dhe në praktikën gjyqësore përkatëse të Panelit Këshillëdhënës të të Drejtave të Njeriut të UNMIK-ut, pritjet mbi aftësinë e një misioni për sundimin e ligjit, siç është EULEX-i, për të hetuar dhe ndjekur rastet sikur kjo këtu, duhet të jetë 'reale' dhe 'proporcionale'. Një vlerësim i asaj që është 'reale' dhe 'proporcionale' në lidhje me një rast të vetme, duhet të marrë parasysh *‘të gjitha faktet përkatëse’* dhe realitetet e punës hetimore *‘siç përskruhet [në parashtrësat e Misionit].’*”

51. Në veçanti, Misioni parashtron se:

“Sipas Librit të Kujtimit të Kosovës’ të Fondit për të Drejtën Humanitare në Kosovë, më shumë se 13,000 individë, nga të cilët mbi 10,000 civilë, u vranë ose u zhdukën në periudhën 1998-2000. Shkalla e krimeve të kryera nënkupton që pritet mbi aftësinë e një misioni për sundimin e ligjit, siç është EULEX-i, për të hetuar dhe ndjekur penalisht këto raste duhet të jenë realiste dhe proporcionale”.

52. Prandaj, Misioni pretendon se:

“Paaftësia për të hetuar një zhdukje të detyruar nuk mund të konsiderohet shkelje e të drejtave të njeriut, kur dështimi për të hetuar materializohet në një kontekst të krimeve në shkallë të gjerë që përfshijnë mijëra viktime dhe ku është e qartë se asnjë autoritet hetimor nuk mund të pritët të zgjidhë të gjitha rastet e sjella para tij. Ky konsideratë zbatohen *a fortiori* në një situatë ku autoriteti përgjegjës nuk është një shtet, por një Mision ndërkombëtar me burime të kufizuara në dispozicion dhe një mandat të kufizuar në kohë (që nga fillimi i tij në 2008, mandati i EULEX-it është zgjatuar çdo dy vjet)”.

53. Misioni gjithashtu pranoi që:

“Menaxhimi i dosjeve të trashëguara nga UNMIK-u ishte një sfidë dhe se [Misioni] nuk ishte në gjendje të korrigjojë shumë mospërputhje dhe dublikime. Ai gjithashtu pranon që njësitë e saj policore dhe prokuroriale duhet të kishin siguruar komunikim më të mirë me viktimat dhe të afërmit e viktimave, dhe gjithashtu me publikun e gjerë. Sidoqoftë, ai pohon se do të kishte qenë thjesht joproporcionale të pritej që Misioni të mund të hetojë të gjitha vrasjet, vdekjet e dyshimta dhe zhdukjet dhe të rihapë rastet që ishin përfunduar tashmë nga autoritetet e UNMIK-ut”.

54. Misioni thekson më tej se:

"Nuk diskuton që ankuesja ka të drejtë për një hetim efektiv mbi vrasjen e djalit të saj. Misioni është gjithashtu i vetëdijshëm dhe e kupton që vuajtjet e znj. Çerimi duhet të jenë të padurueshme dhe me keqardhje të thellë. Sidoqoftë, Misioni gjykon se një vlerësim i sjelljes së EULEX-it nën pjesën procedurale të nenit 2 dhe nenit 3 të Konventës në lidhje me këtë rast specifik nuk mund të shpërfillë madhësinë e sfidës së paraqitur nga numri shumë i lartë i krimeve në lidhje me konflikti, si dhe konteksti dhe rrethanat në të cilat Misioni u thirr për të zbatuar mandatin e tij”.

55. Misioni parashtron se rrethanat në të cilat EULEX-i u thirr për të zbatuar mandatin e tij kishte bërë të nevojshme dhënien e përparësisë së disa rasteve ndaj disa të tjerave. Sidoqoftë, Misioni pranon në parashtrimet e tij se njësitë e tij policore dhe prokuroriale mund të kishin bërë më shumë përpjekje për të mbajtur viktimat dhe publikun e gjerë të informuar për strategjitë dhe qasjet e tij, me qëllim që të menaxhojë pritjet në mënyrë më adekuate dhe që të jetë më transparent.

56. Sidoqoftë, Misioni këmbëngul që në rastin në fjalë dhe duke marrë parasysh pengesat themelore me të cilat u prezantua, nuk beson se të drejtat e ankuesit ishin shkelur.

Parashtrimet si përgjigje

57. Më 17 dhjetor 2020, parashtrësat e Misionit për meritat e lëndës iu përcollën ankueses, e cila u ftua të paraqesë komentet e saj mbi meritat e lëndës, nëse ka pasur, jo më vonë se me 31 janar 2021.

58. Për shkak të një ndërlikimi të paparashikuar me dërgimin e komunikimeve postare, më 1 shkurt 2021, Paneli vendosi të zgjasë afatin për ankuesin që të paraqesë komente mbi meritat e lëndës deri më 19 mars 2021.
59. Asnjë parashtresë tjetër nuk u mor në këtë rast.

VII. VLERSIMI I PANELIT LIDHUR ME PRANUESHMËRINË E LËNDËS

Konsiderata të përgjithshme

60. Misionit iu kërkua të përmbushë përgjegjësitë e tij ekzekutive në një mënyrë që përputhet me standardet përkatëse të të drejtave të njeriut. Kjo nënkuptonte, *ndër të tjera*, se do të hetonte lëndët brenda kompetencës së saj juridikionale që përfshinin shkeljen e të drejtave të garantuara sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Lidhur me standardet përkatëse ligjore të zbatueshme, shih: PShDNj, Shënim i Praktikës Gjyqësore mbi Detyrimin për Hetimin e Pretendimeve të Shkeljeve të të Drejtave, fq. 3-5 (dhe praktikën e cituar gjyqësore); dhe *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi dhe Gjetjet, 19 tetor 2016, par. 36; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi mbi Pranueshmërinë, 30 shtator 2015, par. 88; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi mbi Pranueshmërinë, 29 shtator 2015, par. 58. Shih gjithashtu GjEDNj: *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Aplikacioni nr. 43577/98 dhe 43579/98, Aktgjykimi i 6 korrikut 2005, par. 110; *Hugh Jordan kundër Mbretëria e Bashkuar*, Aplikacioni nr. 24746/94, Aktgjykimi i 4 majit 2001, par. 105; *McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i 27 shtatorit 1995, Seria A nr. 324, par. 161; *Assenov dhe të tjerët k. Bullgarisë*, Aktgjykimi i 28 tetorit 1998, Raportet e Aktgjykimeve dhe Vendimeve 1998-VIII, par. 102.
61. Gjithashtu Misionit i kërkohet t'iu jepte një vlerësim të afërmeve të të zhdukurve në mënyrë të duhur rreth përpjekjeve të veta për të hetuar pretendimet e shkeljeve të të drejtave, fq. 28-30 (dhe praktikën gjyqësore të cituar); dhe *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, paragrafët 61-63; *U.F. Kundër EULEX-it*, 2016-12, Vendimi dhe Gjetjet, 12 shkurt 2020, paragrafi 97; *Milijana Avramović kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-17, 4 qershor 2019, par. 55; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, çështja nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 66; *Desanka dhe Zoran Stanisić kundër EULEX-it*, 2012-22, 11 nëntor 2015, par. 66; shih gjithashtu *Ahmet Özkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 21689/93, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 6 prill 2004, paragrafët. 311-314; *Isayeva k. Rusisë*, Aplikacioni nr. 57950/00, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 24 shkurt 2005 paragrafët. 211-214; *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 7 korrik 2011, par. 167).
62. Lënda këtu, si dhe lëndët e tjera të zhdukjes me forcë/personave të zhdukur, kanë hyrë brenda fushës së atyre kompetencave dhe përgjegjësi.
63. Misioni çon përpara një numër argumentesh në përpjekje për të shpjeguar dështimin e tij për të hetuar lëndën këtu (dhe raste të tjera të ngjashme) dhe për të mbajtur të informuar siç duhet të afërmit e të zhdukurve në këtë rast.
64. Paneli thekson që shumë prej argumenteve apo shumica e tyre tashmë janë ngritur dhe janë refuzuar në raste të mëparshme të të njëjtit lloj. Prandaj, Paneli do të kufizojë konsideratat e tij në atë që është rreptësisht e nevojshme për zgjidhjen e çështjes në fjalë.

Sfidat që lidhen me hetimin e personave të zhdukur/rastet e zhdukjeve me forcë

65. Shefi i Misionit sygjeron që sjellja e Misionit në lidhje me rastet individuale duhet të konsiderohet në bazën e sfidës së përgjithshme që paraqet hetimi i të gjitha rasteve të personave të zhdukur për Misionin. Kjo është e saktë, por vetëm deri në një pikë.
66. Është e saktë, siç Paneli e ka pranuar në mënyrë të përsëritur, se detyra me të cilën përballet Misioni ishte shqetësuese. Në fillim të mandatit të tij, kishte qindra raste që përfshinin shkelje serioze të të drejtave të njeriut për Misionin për të hetuar. Gjithashtu është e saktë që burimet e tij - në ekspertizë, financa dhe personel - ishin të kufizuara. Për më tepër, këto hetime të vështira do të kryheshin vetëm me mbështetje të kufizuar nga autoritetet vendore dhe në një situatë pas konfliktit që do ta bënte një situatë të vështirë edhe më sfiduese. Për më tepër, regjistrat e trashëguar të Misionit nga UNMIK-u ishin mbajtur dhe organizuar dobët. Kjo kërkoi që Misioni të kryejë rishikimin e tij, të përsëritur, të atyre shënimeve. Lidhur me këto vështirësi, shih gjithashtu: *U.F. Kundër EULEX-it*, 2016-12, Vendimi dhe Gjetjet, 12 shkurt 2020, paragrafi 60; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 43-45; *A, B, C, D kundër EULEX-it*, 2012- 09 deri 2012-12, 20 qershor 2013, paragrafi 50; *K to T kundër EULEX-it*, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, par. 53; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi mbi Pranueshmërinë, 29 shtator 2015, paragrafët. 35-37; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi mbi Pranueshmërinë, 30 shtator 2015, paragrafët. 72-74; shih gjithashtu Vendimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut (PKDNj) në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, par. 35 dhe paragrafët 70-71.
67. Argumentimi i përfshirë në parashtresën e shefit të Misionit duke treguar kufizimet e tij nuk lidhet me këtë rast specifik. Përkundrazi ai reflekton mangësi bazike të Misionit, duke përfshirë këto: një mungesë e përgjithshme e planifikimit të duhur për hetimet dhe ndjekjet penale; mungesë të politikës së priorizimit të rasteve; mungesë të përqendrimit në rastet që përfshijnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut; mungesë të hetimeve të shpejta dhe efektive; një dështim i përgjithshëm për të informuar të afërmit e personave të zhdukur; asnjë politikë të qartë për rastet e zhdukjeve me forcë dhe asnjë priorizim të tyre; numër i pakët i lëndëve të personave të zhdukur të "zgjidhura", Mbështetje e paarsyeshme në regjistrat dhe përcaktimin e UNMIK-ut (shih, p.sh. *Q.J. kundër EULEX-it*, 2016-23, Vendimi dhe Gjetjet, 11 dhjetor 2020, paragrafët 45-47; *Vesko Kandić kundër EULEX-it*, 2016-24, Vendimi i Pranueshmërisë dhe Vendimi dhe Gjetjet, 11 dhjetor 2020, paragrafët 80-84); Praktikat e diskutueshme nga personeli i prokurorisë (Shih p.sh. *W. kundër EULEX-it*, 2011-07, Vendimi dhe Gjetjet, 10 prill 2013, paragrafët 34-35; *F. dhe të tjerët kundër EULEX-it*, 2011-27, Vendimi dhe Gjetjet, 5 dhjetor 2017, paragrafët 60-63); veprimet e kryera pa bazë të qartë ligjore (Shih p.sh. *W. kundër EULEX-it*, 2011-07, Vendimi dhe Gjetjet, 10 prill 2013, paragrafët 41-43; *G.T. kundër EULEX-it*, 2019-01, Vendimi dhe Gjetjet, 11 dhjetor 2020, paragrafi 70); dështimi për të kërkuar shënime përkatëse nga burimet e mundshme të informacionit (p.sh., ICRC; autoritetet serbe; OSBE). Këta faktorë, dhe të tjerët, janë të gjithë të dukshëm nga rastet që kanë dalë para Panelit. Këto nuk janë pasoja të sfidave që lidhen me mandatin e Misionit ose me një mungesë të burimeve. Ato janë pasoja e planifikimit të dobët, menaxhim joadekuat operacional të hetimeve dhe ndjekjeve penale, mungesë e politikës së qartë të priorizimit të çështjeve, mosvendosja e një sistemi të komunikimit me familjarët e personave të zhdukur dhe dështimi për të pasur një politikë të qartë hetimore dhe prokuroriale në lidhje me të këtij lloji të rasteve. Ata gjithashtu demonstrojnë një paaftësi nga Misioni për të siguruar që planifikimi dhe zbatimi i aktiviteteve të tij vazhdimisht të marrë parasysh detyrimet e Misionit për të drejtat e njeriut.
68. Paneli dëshiron të theksojë kalimthi se Misioni e kuptoi tashmë gjatë procesit të dorëzimit se kushtet e dosjeve të transferuara ishin larg prej të qenurit adekuate. Prandaj, Misioni

duhej të ishte paralajmëruar se duhet pasur nevojë të afrohej dhe të mbështetej te ato shënime me kujdes. Ai gjithashtu duhet ta kishte paralajmëruar atë për nevojën për të siguruar që aftësia e tij për të përmbushur detyrimet e tij nuk ishte ndikuar negativisht nga ato të dhëna. Si Mision i sapo themeluar, EULEX-i Kosovë pritej të vepronte me kujdesin e duhur dhe në përputhje me detyrimet e veta ndaj të drejtave të njeriut. Për të kuptuar shkallën e detyrave të veta në mjedisin pas konfliktit ishte e nevojshme të njihej me përmbajtjen aktuale të të gjitha dosjeve të lëndës në mënyrë që të drejtat e atyre që ishin të prekur të ruheshin. Kjo duket se nuk ka ndodhur në secilin rast në dëm të viktimave të shkeljeve të të drejtave të njeriut, siç është ankuesi.

69. Bazuar në sa u përmend më sipër, Paneli do të ftojë shefin e Misionit të kryejë një rishikim të plotë të të dhënave hetimore dhe prokuroriale të Misionit gjatë kohëzgjatjes së tij për të pasur një kuptim të qartë, të plotë dhe të informuar të shkaqeve dhe rrethanave të paaftësisë së tij për të përmbushë këtë pjesë të mandatit të tij në mënyrë efektive dhe në një mënyrë në përputhje me detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut. Kjo duhet ta ndihmojë shefin e Misionit të trajtojë trashëgiminë e jashtëzakonshme të të drejtave të njeriut të këtyre dështimeve me qëllim që të sigurojë që Misioni të jetë në gjendje të rregullojë ato shkelje të të drejtave të njeriut që ka kryer gjatë ekzistencës së tij.

Etiketimi ligjor dhe të drejtat e njeriut

70. Në parashtrimet e tij (shih, sipër, par. 55), shefi i Misionit sygjeroi që NjHKL t'i jepte përparësi shqyrtimit të të ashtuquajturve 'dosjeve të krimeve të luftës' ndaj 'dosjeve të personave të zhdukur'. Paneli thekson që dallimi i propozuar nuk mund të konsiderohet i rëndësishëm këtu. Së pari, dallimi është ligjërish artificial: raste të zhdukjes me forcë ose personave të zhdukur mund të përbëjnë krim luftime dhe janë ndjekur penalisht në kategori të ndryshme të krimeve të luftës që prej të paktën Luftës së Dytë Botërore. Shih p.sh., *Vesko Kandić kundër EULEX-it*, 2016-24, Vendimi i Pranueshmërisë dhe Vendimi dhe Gjetjet, 11 dhjetor 2020, paragrafët. 86-92. Paneli vëren në atë aspekt se ishte njësia e krimeve të luftës 'e Misionit që merrej me raste të tilla, duke e bërë të qartë se, edhe nga pikëpamja institucionale, nuk kishte asnjë konflikt midis personave të zhdukur dhe rasteve të krimeve të luftës.
71. *Së dyti*, nga këndvështrimi i ligjit për të drejtat e njeriut, dallimi është i pakuptimtë. Detyrimi për të hetuar që lind në një rast të tillë nga nenet 2 (pjesë procedurale) dhe 3 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut është indiferent ndaj karakterizimit ligjor të dhënë për aktin sipas ligjeve vendore (ose ligjit ndërkombëtar). Me fjalë të tjera, nga këndvështrimi i detyrimeve të tij për të drejtat e njeriut, Misioni nuk ishte më pak i detyruar të hetojë një rast të tillë nëse e konsideronte atë si një rast i krimeve të luftës 'apo si rast i personave të zhdukur'. Shih, p.sh., Konventën Ndër-Amerikane për Zhdukjen e Detyruar të Personave (1994); Asambleja e Përgjithshme e KB, Deklarata për Mbrojtjen e Të gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë, UN Doc A/RRES/47/133, 18 dhjetor 1992 (këtu e tutje Deklarata e 1992 për Zhdukjen me Forcë), art. 1 (1); Këshilli Ekonomik dhe Social i KB, Raporti i Grupit të Punës për Zhdukjet e Detyruara ose të Vullnetshme, Dokumenti i KB i E/CN. 4/1996/38, 1 janar 1996; Komiteti i KB i të Drejtave të Njeriut, Komenti i Përgjithshëm CCPR Nr. 6: Neni 6 (E Drejta për Jetë), 30 prill 1982 (këtu e tutje Komenti i Përgjithshëm Nr. 6), s. 4; Asambleja e Përgjithshme e KB-së, Personat e Zhdukur, UN Doc A/RES/33/173, 20 dhjetor 1978 (në tekstin e mëtejme UN Doc A/RES/33/173); Asambleja e Përgjithshme e KB, Pyetja e Zhdukjeve të Detyruara ose të Vullnetshme, UN Doc A/49/610/Add.2, 23 dhjetor 1994.
72. Për më tepër, Paneli vëren se përparësia e pretenduar që iu ishte dhënë rasteve të "personave të zhdukur" nuk duket se mbështetet nga prova konkrete. Në vend të kësaj, është e qartë nga rastet që kanë dalë para Panelit se rastet që kanë ë bëjnë me personat e zhdukur dështuan të hetoheshin siç duhet, qofshin të etiketuara "krime luftime", "persona

të zhdukur", "aktive" ose "të mbyllur". Në atë kuptim, dështimi duket të jetë rezultat i dështimit për t'i dhënë përparësi këtij lloji të rasteve sesa të jenë shkaktuar nga etiketime ligjore joadekuate, dhe përfundimisht të parëndësishme.

73. Paneli thekson që gjetjet e ngjashme me sa më sipër janë bërë në një numër lëndësh të kaluara para Panelit. Sidoqoftë, Misioni ka vazhduar të sugjerojë që karakterizimi ligjor i lëndës do të vërtetonte dështimin e tij për të përmbushur detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut. Nuk e bën këtë dhe Paneli fton Misionin të mos përsërisë këto parashtrime në të ardhmen.

Mungesa e provave të një hetimi para-ekzistues

74. Në parashtrimet e tij në lidhje me pranueshmërinë e kësaj ankese (shih, më sipër, par. 38), Misioni pranon që:

"Nuk kishte asnjë përfshirje të Misionit në hetimin e vrasjes së Samet Çerimit".

75. Misioni vëren se kishte disa baza të dhënash në Microsoft Access që ishin dorëzuar nga UNMIK-u tek Misioni. Këto përfshinin një për dosjet e policisë "për krime lufte" dhe një tjetër për rastet e "personave të zhdukur". Rasti i Samet Çerimit u përmend në bazën e të dhënave për rastet e "personave të zhdukur", por jo në bazën e të dhënave për dosjet e policisë për "krime lufte". Misioni thekson gjithashtu se nuk kishte asnjë vërejtje specifike që tregon statusin e kësaj çështje si "të hapur", "aktive" ose "joaktive".

76. Misioni sygjeron që kjo ishte për shkak se:

"Në një raport hetimi të datës 26 mars 2001 të lëshuar nga Njësia për Hetimin e Policisë së UNMIK-ut në Mitrovicë thuhet se hetimi për zhdukjen e Samet Çerimit po "ndalohej", sepse kufoma e tij ishte gjetur në lumin Ibër, ndërsa rasti kishte të bënte me një 'vrasje të dyshimtë' ishte ende nën hetim. Një raport i Njesisë për Hetimin e Policisë së UNMIK-ut në Mitrovicë i datës 30 mars 2001 tregon se në ditën e përmendur, policia e UNMIK-ut u takua me familjen e Samet Çerimi (babai i tij dhe ankuesi) për të krahasuar fotografitë e tij me ato të trupit të gjetur në lumin Ibër. Raporti thekson se prindërit e Samet Çerimit nuk e njohën djalin e tyre në fotografitë e treguar atyre nga policia e UNMIK-ut, dhe se për këtë arsye rasti i personit të zhdukur do të mbahej 'i hapur'. Asnjë hap tjetër hetimor duket se nuk është kryer nga UNMIK-u pas asaj date".

77. Prandaj, Misioni në mënyrë efektive pretendon se nuk kishte njohuri për rastin si një hetim i vazhdueshëm penal.

78. Nga ana tjetër, Misioni parashtron se:

"Më 20 prill 2013, NJHKL e EULEX-it mori informacion se eshtra njeriu ishin zbuluar në komunën e Vushtrrisë. Një autopsi u krye nga stafi i EULEX-it i Departamentit të Mjekësisë Ligjore - DFM (tani Instituti i Mjekësisë Ligjore - IFM) më 22 prill 2013. Më 19 shtator 2013, personeli i EULEX-it në DFM lëshoi një certifikatë vdekjeje dhe një certifikatë identifikimi për Samet Çerimi; eshtrat e tij iu dorëzuan ankuesit në 20 shtator 2013".

79. Misioni dështoi të shpjegojë se si ishte se NJHKL-ja e tij mori informacion në lidhje me një trup të pajetë, dhe se anëtarët e stafit të saj në Departamentin e Mjekësisë Ligjore kryen një autopsi ku u përcaktua se shkaku i vdekjes ishte një 'e shtënë me armë në kokë' (shih, sipër, paragrafi 38). Kjo shkak i vdekjes me siguri do të garantonte hapjen e një hetimi. Siç është përmendur nga Paneli në rastet e mëparshme, fakti që informacioni përkatës është

në posedim të një organi të Misionit, kjo do të thotë që vetë Misioni është iu njoftuar lidhur me të. I takon Misionit që të organizohet në një mënyrë që siguron rrjedhën efektive të informacionit dhe në mënyrë që të sigurojë që ai është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut.

80. Për më tepër, vetë anëtarët e stafit të Misionit në Departamentin e Mjekësisë Ligjore ishin në gjendje të identifikonin trupin si atë të Samet Çerimi. Duke bërë atë identifikim, do të ishte e qartë se kjo vdekje kishte shumë të ngjarë të kishte të bënte me zhdukjen e tij në gusht 1999, dhe për këtë arsye, gjithashtu kishte shumë të ngjarë të ishte e lidhur me konfliktin. Prandaj, Misioni ishte plotësisht i informuar për rrethanat e përgjithshme që kishin të bënin me këtë rast dhe faktin që iu kërkua, si pjesë e mandatit të tij, të hetonte rrethanat në të cilat viktimat ishin vrarë dhe ishin zhdukur.
81. Shpjegimet e Misionit nuk arrijnë të bindin për arsye të tjera. Pavarësisht nëse UNMIK-u ishte angazhuar apo jo në një hetim të vazhdueshëm për zhdukjen dhe vdekjen e Samet Çerimit në kohën e dorëzimit të shkresave të lëndës tek EULEX-i, me pranimin e tij, në 2013 vetë Misioni kishte të gjitha informacionet, të cilat kërkoheshin që të justifikoheshin hapja e një hetimi mbi vdekjen e dhunshme të Samet Çerimit. Përgjegjësia e tij për të hetuar buroi drejtpërdrejt nga mandati i tij - kjo nuk varej nga pikëpamja apo konsiderata e UNMIK-ut. E as nuk ishte e varur nga UNMIK-u që e kishte konsideruar atë rast si të hapur ose të mbyllur.
82. Pra edhe duke mos e ditur se cilët ishin hapat hetues (nëse ka pasur) të ndërmarra nga UNMIK-u pas 30 marsit 2001, marrja e informacionit në 2013, dhe përderisa kishte mandat ekzekutiv deri në mes të qershorit 2018, Misioni ishte në gjendje të hetojë rastin.
83. Nga të dhënat, është e qartë se nuk janë bërë përpjekje të tilla. Për më tepër, Misioni mund t'i ketë kushtuar vëmendje këtij rasti edhe pasi ankesa aktuale i ishte komunikuar ShM-së në vitin 2016. Në vend të kësaj, Misioni u përqendrua që të ankohej për të metat e procesit të dorëzimit të dosjeve sesa për aktivitetet që orientoheshin kah viktimat. Ndërsa ato mangësi do të kishin qenë të rëndësishme për të vlerësuar sa apo sa kohë iu desh Misionit për të lëvizur, ai nuk mund të justifikojë ose shpjegojë dështimin e tij për të vepruar.
84. Misioni nuk mund të përdorë dështimin e tij që të kryej hetime për t'u justifikuar me mungesën e informacionit. Informacioni lind nga hetimi, jo e kundërta. Prandaj ishte përgjegjësia e Misionit të provonte dhe të merrte një informacion të tillë. Ndërsa detyrimet e tij në atë drejtim ishin një nga mjetet, e jo rezultat, nga të dhënat shihet se ai as që u përpoq të kërkonte dhe të merrte informacion, përveç asaj që trashëgoi nga UNMIK-u.
85. Parashtrimi i Misionit sygjeron gjithashtu se duhet të ketë pasur disa mangësi serioze në mekanizmat e tij të brendshëm të komunikimit. Si mund të shpjegohet ndryshe që NjHKL-ja merr informacion në lidhje me një trup të vdekur, ku më pas Departamenti i Mjekësisë Ligjore identifikon një shkak të dhunshëm të vdekjes, dhe megjithatë ky informacion me sa duket nuk kthehet në NjHKL, dhe nuk çon në hapjen e një hetimi rreth vdekjes? Ose stafi i Misionit nuk i ka përmbushur funksionet e tij me zell ose Misioni nuk ka arritur të vendosë një sistem të brendshëm të shkëmbimit të informacionit që do të siguronte që informacioni i rëndësishëm për një pjesë të Misionit të bartej tek tjetri. Në secilin rast Misioni është fajtor.
86. Arsyetimi që përfshihet në parashtresat e ShM-së dëshmon se Misioni nuk e kuptonte faktin se për sa kohë sa shkresat e lëndës të dorëzuara nga UNMIK-u kishin mbetur në posedim të EULEX-it, Misioni ishte i ngarkuar me rastet, pra ishte kompetent dhe përgjegjës për fillimin ose vazhdimin e veprimtarisë hetimore, deri në momentin kur autoritetet e Kosovës ishin informuar zyrtarisht për ato raste dhe dosjet e transferuara ose derisa të ishin përmbushur të gjitha detyrimet e tij në lidhje me atë rast.

87. Paneli thekson që detyrimet ndaj të drejtave të njeriut të Misionit nuk janë të kufizuara. Detyrimet që rrjedhin nga nenet 2 dhe 3 të Konventës për të hetuar këtë lloje të rasteve duhet të përmbushen, pavarësisht nga cilësia e provave. Për më tepër, siç u përmend më lart, kishte prova mbi të cilat mund të kishte filluar një hetim. Do të ishte absurde nëse një autoritet mund të heqë veten nga detyrimet e tij hetimore për shkak të mungesës së informacionit para se të fillojë të hetojë. Marrja e informacionit është pika kryesore e një hetimi. Nëse, pas një përpjekje efektive dhe të arsyeshme për të hetuar në përpjesëtim me rëndësinë e të drejtave në fjalë, nuk mund të merret asnjë informacion ose ai është i pamjaftueshëm, autoritetet nuk mund të mbahen përgjegjës për mos gjetjen e më shumë informacione. Sidoqoftë, këtu nuk ndodh kështu. Misioni as nuk u përpoq as nuk filloi të hetojë. Prandaj nuk mund të përdorë mungesën e informacionit (të duhur ose të mjaftueshëm) si bazë për dështimin e tij për të filluar një hetim.
88. Siç u përmend më lart, Misioni gjithashtu sygjeron se nuk kishte njohuri për rastin, sepse me sa duket ishte duke u zhvilluar një hetim nga UNMIK-u para dorëzimit të dosjeve të lëndës.
89. Paneli nuk mund ta pranojë këtë si arsytim për dështimin e Misionit për të vepruar. Së pari, siç ka nënvizuar Misioni në mënyrë të përsëritur, ai e dinte që të dhënat e UNMIK-ut ishin jo të besueshme. Kjo duhet të kishte ngritur shqetësime në lidhje me cilësinë e punës dhe zellit të dhënë ndaj përgjegjësive të tij hetimore. Edhe nëse jo, përgjegjësitë ndaj të drejtave të njeriut të Misionit ishin të vetat. Ato nuk mund t'iu delegoheshin palëve të treta, përfshirë UNMIK-ut. Prandaj ishte përgjegjësia e Misionit t'i rishikonte ato regjistra (siç bëri) në mënyrë që të formonte mendimin e vet për rrjedhën e veprimit që do të ndërmerrej në lidhje me secilin rast individual. Mungesa e dukshme e një hetimi nga UNMIK-u nuk kishte asnjë ndikim ligjor në përgjegjësitë e vetë Misionit.
90. Prandaj, një shpjegim i tillë nuk jep asnjë justifikim për dështimin e Misionit për të hetuar këtë rast dhe për të mbajtur të informuar familjarët e të zhdukurve siç duhet.

Njoftimi për të afërmit e personit të zhdukur

91. Misioni nuk ka paraqitur ndonjë shpjegim të menjëhershëm për dështimin e tij për të informuar të afërmit e të zhdukurve në këtë rast rreth veprimeve të tij ose vendimit për të mos hetuar këtë rast. Kjo pavarësisht nga fakti se, në vitin 2013, të afërmit duhej të ishin të informuar për identifikimin e trupit të Samet Çerimit, dhe duhet të ishin kontaktuar për të rregulluar marrjen e trupit të tij.
92. Në këtë kontekst, cilësia ose mjaftueshmëria e supozuar joadekuate e informacionit nuk kishte asnjë ndikim në detyrimin e Misionit për të informuar të afërmit. Me ose pa një informacion të tillë, ishte e nevojshme që të informoheshin të afërmit e personave të zhdukur për veprimet dhe përpjekjet e tyre. Misioni ka dështuar të bëjë këtë dhe nuk ka dhënë arsye të arsyeshme për atë dështim.
93. Bazuar në sa më sipër, Paneli konstaton se Misioni ka dështuar të përmbushë detyrimin e tij sipas nenit 2 (pjesë procedurale) dhe nenit 3 të Konventës për të mbajtur të afërmit e ngushtë të Samet Çerimit të informuar në mënyrë të duhur rreth rrjedhës së veprimit të ndërmarrë për të hetuar.

Lidhur me nenin 3 të konventës

94. Paneli rikujton praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me rrethanat ku e drejta për liri nga trajtimi çnjerëzor mund të shkelet në rastet e zhdukjes me forcë. Në Aktgjykimin e saj në *Basayeva dhe të tjerët kundër Rusisë* (nr. 15441/05 dhe 20731/04, Aktgjykimi i 28 majit 2009, par. 159), Gjykata vërejtë se:

"Pyetja nëse një anëtar i familjes së një "personi të zhdukur" është viktimë e trajtimit në kundërshtim me nenin 3 do të varet nga ekzistenca e faktorëve të veçantë që i japin vuajtjeve të aplikantëve një dimension dhe karakter të ndryshëm nga shqetësimi emocional që mund të konsiderohet si i shkaktuar në mënyrë të pashmangshme të familjarët e një viktime të një shkeljeje të rëndë të të drejtave të njeriut. Elementet përkatëse do të përfshijnë afërsinë e lidhjes familjare, rrethanat e veçanta të marrëdhënies, shkallën në të cilën anëtari i familjes dëshmoi ngjarjet në fjalë, përfshirja e anëtarit të familjes në përpjekjet për të marrë informacion në lidhje me personin e zhdukur dhe mënyrën në të cilën autoritetet iu përgjigjën atyre pyetjeve. Gjykata do të theksonte më tej se thelbi i një shkeljeje të tillë nuk qëndron kryesisht në faktin e "zhdukjes" së anëtarit të familjes, por përkundrazi ka të bëjë me reagimet dhe qëndrimet e autoriteteve për situatën kur ajo ishte vënë në vëmendjen e tyre. Është veçanërisht në lidhje me këtë të fundit që një i afërm mund të pretendojë drejtpërdrejt se është viktimë e sjelljes së autoriteteve (shih *Orhan kundër Turqisë*, nr. 25656/94, § 358, 18 qershor 2002, dhe *Imakayeva kundër Rusisë*, nr. 7615/02, § 164, 9 nëntor 2006)".

95. Në rastin në fjalë, djali i ankuesit, Samet Çerimi, ishte zhdukur në verën e vitit 1999. Megjithëse një trup potencialisht që përputhej me përshkrimin e tij u gjet në mars 2001, nuk provoi të ishte djali i ankuesit. Fakti që ishte paraqitur - gabimisht, si i tillë për familjen del se ka qenë traumatizues. Kjo krijoi shpresa të rreme dhe shpresa të zhgënjyera.
96. Vetëm në shtator të vitit 2013 trupi i Samet Çerimit u identifikua dhe u kthye në familjen e tij. Kjo nuk duket se është shoqëruar me ndonjë lloj shpjegimi ose zotimi që rasti do të hetohej nga Misioni.
97. Në ndërkohë, ankuesja kishte raportuar zhdukjen e djalit të saj tek autoritetet hetimore të UNMIK-ut dhe ajo ishte këshilluar për identifikimin e trupit të gjetur nga UNMIK-u në vitin 2001. Ajo nuk mori asnjë informacion si përgjigje nga Misioni.
98. Më pas për identifikimin e trupit të djalit të saj në shtator 2013, trupi iu kthye asaj. Për më tepër, ishte lëshuar një certifikatë vdekjeje që tregonte shkaku të vdekjes si 'të shtëna me armë në kokë'. Identifikimi i trupit, kryerja e autopsisë dhe lëshimi i një certifikate vdekjeje, të gjitha ishin kryer nga anëtarët e stafit të EULEX-it. Rrethanat e përshkruara në certifikatë do të kishin qenë të tilla që të krijonin një pritje të arsyeshme nga ana e saj që vdekja e të afërmit të saj do të hetohej. Nuk do të ishte ashtu. Për faktin se i afërmi i saj ishte zhdukur dhe fati i tij nuk dihej, ajo tani duhej të jetonte me dijeninë se asgjë nuk po bëhej në lidhje me të.
99. Siç u përmend, bazuar në këtë renditje ngjarjesh, do të kishte qenë e arsyeshme që ankuesja të supozonte se një hetim mbi zhdukjen dhe vrasjen e djalit të saj do të vazhdonte. Ka pasur qartas hapa të ndërmarra nga UNMIK për të hetuar rastin e djalit të saj. Një shkak i vdekjes ishte vërtetuar dhe provat mjeko-ligjore u gjetën në trupit të viktimës. Vetëm përmes komunikimeve ndërmjet Panelit dhe shefit të Misionit tani është bërë e qartë se nuk kishte, në të vërtetë, asnjë hetim të vazhdueshëm të UNMIK-ut për zhdukjen dhe vrasjen e Samet Çerimit.
100. Pas kthimit të trupit të djalit të saj në shtator 2013, do të kishte qenë edhe më e arsyeshme që ankuesja të supozonte se po ndërmerrej një hetim për vdekjen e djalit të saj. Singërisht është alarmante se si Misioni nuk jep asnjë shpjegim pse nuk e kishte bërë një gjë të tillë.
101. Ndërsa kthimi i trupit të djalit të saj në 2013 mund të ketë shërbyer për të lehtësuar në një farë mase vuajtjet e ankuseses, në mungesë të ndonjë informacioni në lidhje me rrethanat

e rrëmbimit dhe vdekjes së djalit të saj, pasiguria rreth fatit të djalit të saj do të ketë mbetur. Dhe kështu duke e ditur se vrasësi(et) e djalit të saj do të mund të iknin.

102. Kjo pasiguri zbulohet se është edhe më e plotë duke pasur parasysh paditurinë totale të pretenduar të Misionit rreth rastit të djalit të saj, dhe mungesën e plotë të ndonjë hapi hetimor të ndërmarrë nga Misioni pas zbulimit të vetë Misionit dhe identifikimit të trupit të djalit të saj në vitin 2013.
103. Në këto rrethana, Paneli konsideron se shpërfillja e plotë nga ana e Misionit ndaj detyrimit të vet për të kryer një hetim mbi zhdukjen dhe vdekjen e Samet Çerimit dhe mospërfilla e dukshme me të cilën ata u morën me këtë rast përbën pikërisht faktorë të tillë të veçantë që garantojnë konkluzionin se qëndrimi i Misionit ndaj ankueses përbën shkelje të së drejtës së saj për liri nga trajtimi çnjerëzor, siç garantohet nga Neni 3 i Konventës. Siç u tregua në një gjykim nga Gjykata Ndër Amerikane e të Drejtave të Njeriut, "shkelja e integritetit mendor dhe moral të atyre të afërmve është pasojë e drejtpërdrejtë e zhdukjes së tij të detyruar. Rrethanat e zhdukjeve të tilla shkaktojnë vuajtje dhe ankth, përveç ndjenjës së pasigurisë, zhgënjimit dhe pafuqisë përballë dështimit të autoriteteve publike për të hetuar" (shih lëndën Blake kundër Guatemallës, Aktgjykimi i 24 janarit 1998, meritat, paragrafi 114).

Mandati i vazhduar ekzekutiv

104. Misioni ka përsëritur një parashtresë që ai kishte bërë në rastet e mëparshme se ishte i gatshëm të ndihmojë nëse informacionet e reja në lidhje me të afërmin e ankuesit bëheshin të disponueshme.
105. Paneli më herët ka shprehur vërejtjet e veta në lidhje me parashtresat e tilla, në veçanti, pasi kjo mund t'i japë ankuesit përshtypjen se Misioni është ende i përfshirë në hetimin e kësaj lënde, përderisa nuk është. Për më tepër, siç është vërejtur tashmë, Misioni e di, natyrisht, se pa një hetim, informacioni i tillë nuk ka gjasa të bëhet i disponueshëm. Prandaj është e nevojshme që Misioni të shtojë përmbajtje në fjalët e veta dhe tani të përipiqet të korrigjojë faktin se ai dështoi në detyrimet e veta ndaj ankueses për një periudhë të gjatë kohore gjatë së cilës ishte kompetent dhe kërkohet të hetonte rastin e të afërmit të saj. Shih Q.J. kundër EULEX-it, 2016-23, Vendimi dhe Gjetjet, 11 dhjetor 2020, paragrafët. 60-64.
106. Paneli është ende në pritje të një përgjigje ndaj ftesës së tij që shefi i Misionit duhet të marrë në konsideratë për të miratuar një strategji të plotë dhe efektive për Misionin për ta bërë çështjen e të zhdukurve përparësi të Misionit.
107. Derisa të ndodhë kjo, Paneli do të ftojë Misionin të përmbahet nga përsëritja e 'gatishmërisë së tij për të ndihmuar', e cila tashmë është regjistruar nga Paneli dhe e cila nuk i siguron ankuesit ndonjë formë të mjetit juridik, por përkundrazi mund të krijojë pritje të rreme në një situatë të vuajtjeve të vazhdueshme për shkak të zhdukjes së pazgjidhur të një të afërmi të ngushtë.

Konkuzionet dhe gjetjet

108. Bazuar në sa më sipër, Paneli konstaton se Misioni ka shkelur të drejtat e ankueses sipas nenit 2 (pjesë procedurale) dhe 3 të Konventës duke dështuar të hetojë zhdukjen e të afërmit të saj dhe duke dështuar të sigurojë atë dhe të afërmit e tjerë të ngushtë me ndonjë informacion në lidhje me këtë rast. Duke marrë parasysh seriozitetin e të drejtave në fjalë, peshën e dështimit të Misionit dhe kohëzgjatjen e kohës në fjalë, shkelja duhet të konsiderohet si veçanërisht serioze. Shkelja është duke vazhduar ende.

109. Prandaj, ftohet shefi i Misionit të marrë hapa dhe masa që janë në përputhje me këtë fakt.
110. Bazuar në ato gjetje, Paneli e konsideron të panevojshme të bëjë gjetje shtesë në lidhje me nenet 8 dhe 13 të Konventës. Sidoqoftë, është mjaft e dukshme që sjellja e Misionit ka pasur një efekt negativ në të drejtat e ankuesit, siç mbrohen nga ato dispozita. Në vlerësimin e tij se cilat masa ose hapa duhet të ndërmerren për të korrigjuar shkeljet e regjistruara në këtë vendim, shefi i Misionit ftohet të jep shpjegime për këtë fakt.
111. Në këtë kontekst, Paneli fton Misionin t'i kushtojë vëmendje të duhur domosdoshmërisë dhe efektivitetit të ngritjes në mënyrë të përsëritur të argumenteve dhe pikave të njëjta, të cilat tashmë janë adresuar në rastet e mëparshme dhe vlerësuar negativisht. Paneli fton Misionin t'i mbështesë parashtresat e tij në të ardhmen me një analizë të aktiviteteve të Misionit siç shihet nga perspektiva e detyrimeve të veta ndaj të drejtave të njeriut.
112. Paneli gjithashtu do të ftojë shefin e Misionit të marrë parasysh nevojën që Misioni të kryejë një rishikim transparent dhe efektiv të aktiviteteve dhe trashëgimisë së tij - në veçanti, nga këndvështrimi i detyrimeve të tij ndaj të drejtave të njeriut - në mënyrë që të nxjerrin mësim nga përvoja e Misionit për përpjekje të tilla në të ardhmen.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

GJEN se ankesa është e pranueshme në përputhje me nenet 2 (pjesë procedurale), 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;

GJEN se Misioni ka shkelur të drejtat e ankuesit siç janë të mbrojtura në nenet 2 (pjesë procedurale), 3 të Konventës;

MË TEJ GJEN se shkeljet janë serioze dhe të vazhdueshme dhe se, për këtë arsye, kërkojnë miratimin e masave korrigjuese në përpjesëtim me to;

I BËN THIRRJE shefin e Misionit të zbatojë masa korrigjuese në përpjesëtim me peshën e shkeljeve të përfshira;

GJEN se nuk ka nevojë të bëjë konkluzione mbi meritat në lidhje me nenet 8 dhe 13 të Konventës;

FTON SHEFIN E MISIONIT, në veçanti, të rishikojë interpretimin e dhënë aktualisht për natyrën dhe fushën e detyrimeve të Misionit ndaj të drejtave të njeriut dhe të marrë në konsideratë sa vijon:

1. Paneli fton shefin e Misionit të konsiderojë zyrtarisht pranimin e shkeljes së të drejtave të ankuesit nga Misioni dhe të ofrojë mjet juridik të duhur për të.
2. Paneli fton Misionin të vazhdojë kërkimin dhe identifikimin e zyrës së prokurorisë përgjegjëse për hetimin e kësaj lënde.
3. Paneli më tej fton Misionin të hetojë, si pjesë e veprimtarisë monitoruese, me prokurorin kompetent nëse lënda po hetohet, e nëse jo pse.
4. Paneli fton Misionin të marrë parasysh se cilat hapa konkretë dhe domethënës duhet të ndërmerren për të kontribuar në çuarjen përpara të hetimit të rasteve të zhdukjeve me forcë/personave të zhdukur. Paneli është i gatshëm të vazhdojë të bashkëpunojë me shefin e Misionit në përpjekjen për të gjetur zgjidhje për atë qëllim. Megjithatë, Paneli dëshiron të vërejë se hapat e ndërmarrë deri më tani nga Misioni janë

joadekuatë nga pikëpamja e detyrimeve të Misionit ndaj të drejtave të njeriut dhe jo të afta për të kontribuar në mënyrë domethënëse në zgjidhjen e atyre rasteve. Është koha e duhur që Misioni të bëjë më shumë.

5. Paneli fton shefin e Misionit të shqyrtojë me kujdes se cilat mjete juridike janë akoma në dispozicion të Misionit në një rast siç është ky rast ku Misioni është gjetur se ka shkelur të drejtat e një të afërmi të një personi të zhdukur dhe të informojë Panelin në lidhje me konkluzionet e tij.
6. Paneli fton Misionin të shpërndajë këtë vendim në
 - i. Personelin përkatës brenda Misionit;
 - ii. Zyrtarët përkatës të Bashkimit Evropian që kanë përgjegjësi për Kosovën, Misionet e Politikave të Përbashkëta për Siguri dhe Mbrojtje (MPPSM), ose çështjeve të të drejtave të njeriut.

FTON Misionin t'i raportojë Panelit në lidhje me rekomandimet e mësipërme sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se data 30 nëntor 2021.

Për Panelin,

Guénaël METTRAUX
Kryesues

Anna BEDNAREK
Anëtare

Anna AUTIO
Anëtare